

The background features a complex, three-dimensional wireframe structure in shades of blue. It consists of numerous intersecting lines that form a grid-like pattern, which is curved and twisted to create a sense of depth and movement. In the center of this structure is a smooth, glowing sphere that appears to be the focal point of the design. The overall aesthetic is futuristic and digital.

BANKAT NË
EPOKËN E
INTERNETIT

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë, Shqipëri,

Tel.: +355-(0)4-222152;

Faks: +355-(0)4-223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 6000 kopje

Në vend të parathënies	5
1. Hyrje	7
2. Çfarë është <i>Internet Banking</i> ?	8
3. Shërbimet që ofrohen në rrugë elektronike	11
4. Kur dhe si lindi <i>Internet Banking</i> ?	14
5. Përparësitë dhe përfitimet që sjell <i>Internet Banking</i>	17
6. Kostot dhe të metat e <i>Internet Banking</i>	19
7. Siguria	22
8. Forma të tjera bankingu	26
9. <i>Internet Banking</i> në Shqipëri	28
10. E ardhmja e <i>Internet Banking</i>	32
Botime edukative të Bankës së Shqipërisë	35

Në vend të parathënies

Të dashur lexues,

Cili nga ju kishte menduar para jo shumë vjetësh, se një ditë do të kryente veprime financiare nëpërmjet një banke që e shikon dhe e prek vetëm në kompjuter? Unë besoj që as në përfytyrimin e më ekstravagantëve kjo ide nuk kishte formë para disa dekadave. E pra, në ditët e sotme është realitet!

Rruga që të çon nga bankat tradicionale, që ne të gjithë njohim, drejt atyre virtuale, të cilat nuk kanë një infrastrukturë bankare reale ose e thënë ndryshe sportele fizike, kalon përmes internet banking. Sot është e mundur që pa lëvizur nga shtëpia apo zyra, të lidhesh me llogarinë bankare personale jo vetëm për të kontrolluar gjendjen e saj, por edhe për të kryer transaksione e pagesa. Ky kanal i ri për ofrimin e shërbimeve bankare mundëson kapërcimin e orareve, kursen humbjet e kohës dhe mënjanon rradhët dhe aspektet burokratike të bankingut tradicional.


Sa do të zhvillohet dhe do të përhapet ky lloj i ri i bankingut? Sa do të arrijë të pranohet gjerësisht nga njerëzit në të gjithë botën? Kjo varet nga shumë faktorë, ndër të cilët do të veçoja me siguri e bindje të plotë: traditën, e cila i ka mësuar njerëzit t'ia besojnë "sekretet e tyre financiare" dikujt që ushtron profesionin e bankierit; formimin e përgjithshëm të popullsisë, i cili i jep çertifikatën e shëndetshmërisë dhe të mbijetesës çdo zbulimi apo zhvillimi në fusha të ndryshme; aftësinë e tij për të qenë i suksesshëm, që është dhe mbetet baza mbi të cilën ndërtohet besimi dhe vendoset një marrëdhënie bashkëpunimi e çfarëdolloji.

Duke patur dëshirën e mirë që të gjithë ju ta gjeni të dobishëm dhe interesant këtë botim të Bankës së Shqipërisë, ju ftoj t'i jepni pak nga koha juaj.





Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani.



1. Hyrje

Nëse jeni si pjesa më e madhe e njerëzve, ju keni dëgjuar të flitet për *internet banking*, por ka shumë mundësi të mos e keni përdorur vetë atë. Ju vazhdoni të paguani faturat e telefonit, dritave dhe ujit në sportelet përkatëse, vazhdoni të tërhiqni apo depozitoni personalisht paratë në sportelet e bankës tuaj. Ndoshta ju ndodh të shikoni në internet interesat që bankat e ndryshme ofrojnë për depozitat, komisionet që ato mbajnë për llogaritë apo kushtet që duhen plotësuar për të marrë një kredi, megjithatë kur vjen puna për të vendosur e për të vepruar, ndiheni më mirë e më të sigurt kur ndodheni brenda mureve të një banke, përballë një personi fizik, i cili ju ilustron me rradhë shërbimet dhe ju këshillon për atë që sipas tij është më e përshtatshme për ju.

Të përdorësh *Internet Banking* nuk do të thotë të ndryshosh zakonet e përdorimit të parasë. Përkundrazi, me ndihmën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, mundësohet kapërcimi i orareve, humbjet e kohës dhe aspektet burokratike të bankingut tradicional, për të administruar më shpejt dhe në mënyrë më eficiente financat personale.

Në ditët e sotme, një pjesë e mirë e bankave tregtare ofrojnë forma të ndryshme të *internet banking*, i njohur ndryshe edhe si *online banking* ose *electronic banking* (*e-banking*). Sfida e kësaj industrie është dizenjimi i këtij kanali të ri për ofrimin e shërbimeve bankare, në mënyrë të thjeshtë e të besueshme për t'u përdorur nga klientët. Në fund të fundit, bankat kanë breza të tërë që përpiqen të fitojnë besimin tonë dhe nuk mund të rrezikojnë gjithçka me një faqe interneti të ngatërruar, të lodhshme e mbi të gjitha jo të sigurt.

2. Çfarë është *Internet Banking*?

Të gjitha bankat janë të pranishme në internet me një faqe të tyre, që jep informacion të përgjithshëm mbi bankën dhe mbi shërbimet që ajo ofron. Megjithatë, *internet banking* shkon një hap më tutje, pasi u lejon klientëve të futen nëpërmjet internetit në llogaritë e tyre on-line 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, drejtpërsëdrejti nga shtëpitë ose zyrat e tyre dhe të kryejnë operacionet bankare që duan.

Me fjalë të tjera, *internet banking* mund ta përkufizojmë si një nga shërbimet në distancë, të ofruar nëpërmjet kanaleve elektronike të shpërndarjes dhe të komunikimit, të produkteve dhe shërbimeve tradicionale dhe të reja bankare. Megjithatë, duhet theksuar se *internet banking*, të paktën në fazën aktuale, nuk tenton të zëvendësojë kanalet tradicionale të shpërndarjes së produkteve bankare. Ai qëndron bashkë me një tërësi kanalesh, që shkojnë nga ato tradicionale (si sportelet e filialeve) tek ato automatike (si ATM, Pos), në kuadrin e plotësimit dhe të përforcimit të raportit klient – bankë, për të realizuar të ashtuquajturën strategji shumëkanalëshe.





3. Shërbimet që ofrohen në rrugë elektronike

Pjesa më e madhe e bankave të mëdha, ofrojnë shërbime bankare në rrugë elektronike, plotësisht të sigurta dhe plotësisht funksionale, kundrejt një pagese të caktuar. Disa banka më të vogla ofrojnë akses dhe funksione më të kufizuara, si për shembull të lejojnë të kontrollosh gjendjen e llogarisë personale, por jo të kryesh transaksione *online*.

Në këtë mënyrë, shërbimet që ofron *internet banking* mund t'i klasifikojmë në dy lloje: *informative*, në rastet kur të lejojnë vetëm të kontrollosh bilancin apo pasqyrën e lëvizjeve dhe *operative*, kur të lejojnë të bësh transferta apo të paguash fatura, me fjalë të tjera të kryesh të gjitha operacionet tipike të një sporteli bankar. Dhe të gjitha këto bëhen të mundura pa lëvizur nga shtëpia, duke kursyer kohë dhe duke mënjeluar rradhët e mërzitshme nëpër sportele.

Disa nga shërbimet më të përdorura që mund të ofrohen në rrugë elektronike, të grupuara sipas katër kategorish kryesore, përkatësisht 1) Informacion, 2) Kontrolli i bilancit, 3) Transferrat e fondeve, 4) Kredi si edhe shërbimet bazë si këshillimi financiar etj., janë:

Tabelë. Shërbimet që ofrohen në rrugë elektronike.

Informacion	Kontrolli i bilancit	Transferrat e fondeve	Kredi	Të tjera
Produkte financiare	Gjendja e llogarisë	Transferta	Limiti i kredisë	Këshillimi financiar
Bursa	Gjendja e kartave të debitit/kreditit	Shlyerja e kredisë	Aplikimi	Raporti i incidenteve
Kursi i këmbimit	Gjendja e çqeve personale	Debitimet direkte	Miratimi i kredisë	Administrimi i financave personale
		Pagesat me karta	Transferimi i kredisë	Produkte të tjera financiare



4. Kur dhe si lindi *Internet Banking*?


Që në fillimet e tyre, bankat shërbenin për të mbajtur të sigurtat paratë tona. Ndërkohë që ruajnë paratë tona, ato na lejojnë të marrim edhe një interes mbi paratë e depozituara. Bankat tradicionale e kanë bërë këtë prej shekujsh tashmë, dhe bankat e ditëve tona po vazhdojnë në të njëjtin drejtim, duke ofruar shërbimet tradicionale si dhe shërbime të reja, në rrugë të ndryshme.

Përhapja e teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, rritja e përdorimit të kompjuterave personalë, lehtësimi i lidhjes me internetin, si edhe përhapja e gjerë e telefonave celularë, kanë tërhequr vëmendjen e bankave drejt mundësisë së *internet banking*. Një tjetër arsye që bëri të dobishëm përdorimin e këtij kanali, ishte nevoja për të minimizuar kostot dhe njëkohësisht, për të rritur eficiencën e shërbimeve bankare. Në këtë mënyrë, bankat shfrytëzuan karakteristikën kryesore të internetit, ndërveprimin, duke zhvilluar strukturën e shpërndarjes së shërbimeve bankare për të plotësuar nevojat në rritje të klientëve të tyre dhe njëkohësisht, për të rritur të ardhurat e tyre.

Internet banking ka pak vite që është në qarkullim. Si fillim, ai u prezantua në vitet '80, megjithatë vetëm në mesin e viteve '90 u përhap gjerësisht dhe që atëherë, ka përparuar shumë. Gjatë dekadës së fundit, transaksionet bankare në rrugë elektronike janë rritur në mënyrë marramendëse.



Me *e-banking* kam më shumë **kohë**
për familjen time!



5. Përparësitë dhe përfitimet që sjell *Internet Banking*

Internet banking përmbush shumë funksione në marrëdhënien midis bankës dhe klientelës së saj. Përveç prezantimit dhe njohjes së institutit bankar, iniciativave dhe produkteve të tij, ky lloj shërbimi ofron dhe përfitime të tjera si:

- **Komoditet:** ndryshe nga sportelet bankare, faqet e internetit të bankave nuk mbyllen asnjëherë, ato janë të hapura 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Nuk është e nevojshme të humbësh kohë duke pritur në rradhë, pasi bankat tani janë vetëm një *click* larg.
- **Kudondodhje:** nëse ndodheni larg qytetit tuaj apo edhe jashtë shtetit, ju mund të lidheni në çast me bankën dhe llogarinë tuaj, dhe të kujdeseni për financat personale.
- **Shpejtësi të transaksioneve:** shpesh, llogaritë *online* realizojnë dhe konfirmojnë transaksionet bankare më shpejt se sa automatet ATM.
- **Efikasitet:** ju mund të futeni dhe të administroni të gjitha llogaritë tuaja, përfshirë këtu depozitat, fondet e pensionit, letrat me vlerë etj., dhe të gjitha këto nga një faqe e vetme interneti.
- **Efektshmëri:** një pjesë e madhe e bankave ofrojnë në faqet e tyre të internetit, instrumente të sofistikuara, alarme apo programe drejtuese për t'ju ndihmuar të administroni të gjitha pasuritë tuaja në mënyrë më eficiente.



Një tjetër përparësi e *internet banking* është kontrolli dhe pakësimi i kostove. Mijëra klientë mund ta përdorin këtë shërbim njëkohësisht, pa ndihmën e arkëtarëve dhe të nëpunësve të bankës. Në këtë mënyrë, puna administrative reduktohet dhe bashkë me të edhe shpenzimet për letër, formularë apo shkresa të ndryshme, gjë e cila sjell një rritje të ndjeshme të marzhit të fitimit të bankës dhe për pasojë, edhe ulje të tarifave që bankat u aplikojnë klientëve të tyre.

Një shërbim i tillë ka një rëndësi të veçantë për personat me aftësi të kufizuara, të cilët mund të futen vetë në llogaritë e tyre *online* dhe të kryejnë operacionet e dëshiruara drejtpërdrejt nga shtëpia e tyre, pa qenë e nevojshme të shkojnë fizikisht në bankë apo të ngarkojnë një person të tretë me administrimin e financave personale. Sporteli *online* nuk është thjesht një shërbim më shumë apo kursim kohe, për këtë kategori personash. Ai u garanton atyre diçka shumë të rëndësishme për ta, pasi u jep emancipim dhe u rikthen dinjitetin, duke i lejuar të veprojnë në mënyrë autonome dhe të ruajnë konfidencialitetin e tyre.

6. Kostot dhe të metat e *Internet Banking*

Megjithëse *internet banking* mundëson më shumë komoditet, shpejtësi dhe efikasitet, adoptimi dhe përdorimi i tij duhen menduar mirë.

Për sa i përket bankave, zgjedhja e të kaluarit *online* sjell për to kosto të konsiderueshme. Kostot më të mëdha lidhen me investimin në teknologji. Në rradhë të parë, këto kosto shkojnë për blerjen dhe instalimin e pajisjeve dhe sistemeve *hardware* dhe *software*; së dyti për riorganizimin e strukturës së brendshme, për punësimin e personelit informaticien, për sigurinë dhe për integrimin me sistemin e brendshëm informativ. Për fat të keq, shpenzimet nuk mbarojnë me kaq. Teknologjia ecën me hapa shumë të shpejtë e për të ndjekur ritmin e saj, si dhe për të ruajtur e përmirësuar cilësinë e dhënies së shërbimeve, ka nevojë për përditësime të vazhdueshme të teknologjisë. Gjithashtu, duhen marrë parasysh kostot për mirëmbajtjen e sistemeve, për riparime të defekteve të mundshme, për asistencë teknike dhe për lidhjen me internetin.

Për sa i përket klientëve, kostot fikse që ata duhet të mbulojnë janë fillimisht ato për pajisjen me *hardware* dhe *software* (kompjuter, modem dhe programet e nevojshme). Nga ana tjetër, kostot për përdorimin e shërbimit përfshijnë kostot teknologjike (në rast mosfunksionimi të *hardware*-it ose *software*-it), kostot për lidhjen me internetin dhe në varësi të kushteve specifike të secilës bankë, tarifën

mujore për abonimin dhe komisionet për operacionet bankare të kryera. Në rast se nuk dini ta përdorni këtë teknologji dhe do t'ju duhet të regjistroheni e të ndiqni një kurs kompjuteri, sigurisht që këto janë shpenzime të tjera.

Përveç kostove që duhen mbuluar, ekzistojnë edhe disa të meta apo disavantazhe:

- **Fillimi i shërbimit mund të dojë pak kohë:** për t'u regjistruar në programin *online* të bankës tuaj, mund t'ju duhet të paraqiteni personalisht në bankë, të plotësoni një formular e të prisni deri sa t'ju caktohet emri i përdoruesit (*user name*) dhe fjalëkalimi (*password*).
- **Kurba e nxënies:** në fillim, faqet e internetit të bankave mund të duken të komplikuara për t'u orientuar. Planifikoni të shpenzoni pak kohë për të lexuar udhëzimet e ndryshme dhe për të mësuar se si funksionon dhe çfarë ofron shërbimi *online* i bankës suaj.
- **Probleme teknike:** nëse për probleme të ndryshme nuk arrini të realizoni lidhjen me internetin, ju nuk do të mund të hyni në llogarinë tuaj *online* e të kryeni veprimet për të cilat keni nevojë. Gjithashtu, *internet banking* mund të jetë i ngadalshëm, nëse jeni duke përdorur një modem prej 56k.

-
- **Mungesë bashkëveprimi personal:** me zgjedhjen e këtij kanali për të ndërvepruar me bankën tuaj, ju nuk keni një kontakt personal me nëpunësit e bankës dhe nuk keni këshillat e tyre për të miradministruar financat tuaja.
 - **Nuk mund të depozitoni apo tërhiqni para:** nëpërmjet *internet banking*, ju nuk mund të depozitoni në llogarinë tuaj para fizike apo çeqe. Për këtë, do t'ju duhet të shkoni në bankë. Edhe për të tërhequr para fizike, do t'ju duhet të paraqiteni tek arkëtarja e bankës tuaj apo tek ATM-ja më e afërt.



Për shumë njerëz, vështirësia më e madhe qëndron në të mësuarit e të paturit besim tek shërbimi *online*. Për këtë, është e nevojshme të dimë se sa i sigurt është ky shërbim apo sa të sigurt janë transaksionet që kryhen nëpërmjet tij. Me fjalë të tjera, është e nevojshme të analizohet se sa të sigurt do të jenë paratë tona, po të administrohen në këtë formë.

Ndonjëherë, përdorimi i shërbimeve bankare me anë të internetit mund të sjellë edhe rrezikun e penetrimit nëpërmjet rrjetit në mënyra të ndryshme, si për shembull duke përvetësuar kodin sekret të hyrjes, duke ndërmjetësuar komunikimet me e-mail, duke kryer veprime bankare në emër të të tjerëve etj..

Në mbrojtje të klientit nga kriminaliteti elektronik, bankat që ofrojnë *e-banking* përdorin sisteme të përparuara sigurie, të cilat kodojnë të gjithë informacionin që qarkullon mes bankës dhe klientit. Në këtë mënyrë, me anë të procedurave të ndryshme të kriptografisë, bankat i garantojnë klientëve të tyre sigurinë, integritetin dhe disponueshmërinë e produkteve dhe shërbimeve bankare që ato ofrojnë.

Nga ana juaj, edhe ju si klientë mund të bëni diçka për t'u vetëmbrojtur. Mjafton të ndiqni disa këshilla të thjeshta praktike dhe gjithçka do të jetë plotësisht e sigurt.



- Bëni kujdes kur të vendosni fjalëkalimin (*password*) e llogarisë tuaj *online*. Zgjidhni diçka të lehtë për t'u kujtuar, por të vështirë për t'u gjetur nga të tjerët (mos përdorni emrin, mbiemrin, ditëlindjen tuaj apo ato të personave tuaj të afërt dhe as emrin e ndonjë personazhi publik apo të qenit tuaj).
- Mos hyni kurrë në llogarinë tuaj *online* nga një kompjuter publik. Evitoni të përdorni kompjuterat e bibliotekave, të shkollave apo ata të internet-kafeve, pasi disa faqe interneti vendosin *cookies* në kompjuter, që mbledhin informacionin tuaj personal.
- Edhe nëse jeni duke përdorur kompjuterin tuaj personal, mos e lejoni faqen e internetit të bankës të "mbajë mend" emrin tuaj të përdorimit apo fjalëkalimin.
- Mos u lidhni me faqen e *internet banking* nëpërmjet një *link*-u (lidhje) në e-mail ose në motorët e kërkimit në internet, më mirë shtypeni vetë adresën elektronike të bankës suaj, për më shumë siguri.
- Bëni kujdes nga të ashtuquajturit "*phishers*". Këta janë hajdutë të teknologjisë së lartë, të cilët dërgojnë e-mail, duke deklaruar se përfaqësojnë banka apo institucione të tjera financiare dhe se për të përfituar informacionin që ata

kanë mbi klientët e tyre, kanë nevojë për të dhënat tuaja personale, përfshirë numrin e llogarisë, emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Mos u gënjeni nga sofistikimi i këtyre mesazheve dhe mos iu përgjigjini. Banka nuk do t'ju kërkojë kurrë një informacion të tillë me e-mail dhe as me telefon.

- Kontrollojeni vazhdimisht gjendjen e llogarisë dhe transaksionet tuaja. Në rast se vini re gabime apo transaksione të paautorizuara, njoftoni menjëherë bankën.
- Dhe mos harroni të ç'regjistroheni dhe të mbyllni të gjitha faqet e hapura pas përfundimit të përdorimit të shërbimit *online*.

sign out

8. Forma të tjera bankingu

PC Banking

PC banking është i ngjashëm me *internet banking*, me të vetmin ndryshim se nuk përdoret interneti për t'u lidhur me llogarinë personale. Në vend të tij, nga kompjuteri juaj personal, ju mund të lidheni drejt e me intranetin e bankës tuaj, duke përdorur një *software* të posaçëm, një modem dhe linjën telefonike ekzistuese. Në përgjithësi, *PC banking* ofron të njëjtin nivel veprimi si *internet banking*, por është potencialisht më i shpejtë dhe ofron më shumë siguri.

Telephone banking

Telephone banking është shërbimi i ofruar nga institucionet bankare për të kryer operacione bankare nëpërmjet telefonit. Shumica e bankave që ofrojnë këtë shërbim, përdorin *interactive voice response (IVR)*, megjithatë në telefon mund t'ju përgjigjet edhe një operator nga *call center*-i i bankës. Për të garantuar sigurinë, ju identifikoheni në fillim nëpërmjet një fjalëkalimi numerik ose verbal, ose nëpërmjet disa pyetjeve sigurie, të bëra drejtpërdrejt nga një operator. Me përjashtim të tërheqjes së parave dhe depozitave, ai ofron pothuaj të gjitha veçoritë e një ATM: informacion mbi gjendjen e llogarisë dhe listën e transaksioneve të fundit, pagesa të faturave elektronike, transferimin e fondeve etj..

Mobile Banking

Mobile ose *SMS banking* përdor një tjetër teknologji për të vepruar me llogaritë personale, pa u paraqitur fizikisht në bankë. Me përdorimin e gjerë të telefonave celularë kohët e fundit, bankat kanë menduar t'i afrohen klientëve të tyre edhe me anë të SMS-ve. Kështu, me anë të mesazheve të shkurtra në formë teksti, bankat i informojnë ata për gjendjen e llogarisë, transaksionet e fundit, hyrje/daljet në llogari më të mëdha se një shumë e përcaktuar etj..

TV Banking

Një tjetër mënyrë për ta futur bankën brenda shtëpisë së klientëve është *TV banking*. Nëpërmjet opsionit interaktiv të telekomandës së televizorit, ju mund të hyni në faqen e bankës suaj dhe të shikoni një gamë informacioni mbi shërbimet e ofruara. Pas regjistrimit për këtë shërbim, ju mund të përdorni gati të gjitha shërbimet e përmendura më sipër. Për t'u lidhur me llogarinë personale, aparati i televizorit duhet të jetë i lidhur me linjën e telefonit por nëse kjo lidhje është e dëmtuar, atëherë ju nuk do të mund të futeni në llogarinë tuaj.

9. Internet Banking në Shqipëri

Pjesa më e madhe e produkteve të ofruara nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, bëjnë pjesë në paketën tradicionale të shërbimeve: depozitime, llogari, transfertat. Depozitat kanë qenë produkti më i njohur nga ana e publikut, por vitet e fundit, përpjekjet për minimizimin e transaksioneve në *cash* (kanalizimi i pagave të punonjësve nëpërmjet bankave) sollën një zhvillim të shpejtë edhe për produktet e tjera (mund të përmendim këtu kreditë, overdraftet, kartat etj.). Një pjesë e përdoruesve, fillimisht i panë me mosbesim produkte të tilla dhe u munduan të qëndronin larg tyre, por gradualisht, me rritjen e sasisë së informacionit rreth avantazheve të këtyre produkteve, përdorimi i tyre po kthehet në rutinë.

Në këtë proces, bankat kanë rolin kryesor në edukimin e publikut lidhur me produktet e reja. Në funksion të këtij qëllimi, janë forcuar kërkesat rregullatore për transparencën e operacioneve bankare me publikun (publikimi i kushteve të punës në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme për të mundësuar krahasimin e tyre midis bankave).

Pas familjarizimit me produktet e mësipërme, është rradha e prezantimit të *internet banking* edhe në Shqipëri. Banka e parë që e ka ofruar këtë produkt është Banka Amerikane e Shqipërisë që në vitin 2002, me prezantimin e ABAflex. Ende sot, ajo mbetet banka e vetme që ofron një paketë të qenësishme shërbimesh nëpërmjet internetit. Ka patur përpjekje edhe nga banka të tjera për ofrimin e shërbimeve

të tilla, si për shembull Banka Raiffeisen, me anë të *MultiCash*, ofron shërbimin e transfertave. Por, kjo i rezervohet vetëm një numri të kufizuar klientësh të zgjedhur, pasi i drejtohet kryesisht kompanive “duke lënë pas dore” individët. Në hapat e parë të ofrimit të këtij shërbimi janë edhe Banka Popullore dhe Banka Credins, të cilat për momentin ofrojnë vetëm informacion mbi llogarinë.

Faktet e mësipërme flasin për një *internet banking* në fillimet e tij, në Shqipëri. Megjithëse në tregun shqiptar ekzistojnë banka që kanë mbështetjen e grupeve të fuqishme bankare të huaja, ky shërbim ende nuk është i zhvilluar. Arsyeja kryesore është raporti kosto – përfitim. Nëse nuk ka një numër të rëndësishëm klientësh që do të përdorin këtë shërbim, kostot e larta që lidhen me ofrimin e tij, të përmendura më lart, do të sillnin humbje për bankat. Nga ana tjetër, nëse nuk ofrohet një shërbim i caktuar është e vështirë të përcaktohet numri i përdoruesve potencialë të tij. Duket sikur është një rreth vicioz, megjithatë pika kyçe në këtë rreth mbetet infrastruktura e telekomunikacionit. Duket se zhvillimi i kësaj infrastrukture ka nxitur disa nga bankat të marrin përsipër sfidat për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Nisur nga ecuria e produkteve të kartave dhe kredive, ndoshta edhe *internet banking* në Shqipëri do të ketë një zhvillim të shpejtë në të ardhmen. Megjithatë, kjo do të varet në rradhë të parë, nga siguria që do të ofrojnë bankat lidhur me këtë shërbim dhe së dyti, nga transparenca me klientët mbi kostot e tij.

Megjithatë, nëse jeni të interesuar për të përdorur këtë shërbim, për më shumë informacion, drejtojuni bankës tuaj për t'u informuar nëse ajo ju ofron ose jo mundësinë e *internet banking*. Gjithashtu, para se të firmosni formularin e regjistrimit përkatës, informohuni mbi kushtet e përdorimit, tarifat dhe llojet e veprimeve që ky shërbim ju lejon.



internet banking

10. E ardhmja e *Internet Banking*

Një vështrim i shpejtë mbi llojet e bankave dhe shërbimet që ato ofrojnë, na jep një panoramë të shumëllojshme të këtij sistemi. Kështu për shembull, pjesë e tij janë si bankat tradicionale me degët dhe filialet e tyre fizike të shpërndara në mënyrë që t'i afrohen sa më pranë klientëve të mundshëm, ashtu edhe bankat virtuale, të cilat nuk kanë një infrastrukturë bankare tradicionale, pra sportele fizike, por ekzistojnë vetëm *online*. Një rrugë e mesme në këtë mori ofertash përbëhet nga shërbimet bankare *online* të paraqitura nga bankat tradicionale, si një alternativë e çmuar ndaj humbjeve të kohës në administrimin më eficient të financave personale.

Pas një fillimi të ngadaltë, mund të themi se aktualisht, *internet banking* ka hyrë në një fazë zhvillimi. Ky zhvillim vjen si rezultat i përhapjes së shpejtë të internetit, afirmimit gjithmonë e më të madh të produkteve që ai ofron dhe reduktimit të kostove të pajisjeve informatike. Megjithatë, kur vihet në diskutim e ardhmja e tij, dalin në pah teza dhe mendime të ndryshme. Kishte nga ata që menduan se ofrimi i një shërbimi të tillë do të pasohej nga zhdukja ose minimizimi i përdorimit të kanaleve tradicionale për marrjen e shërbimeve bankare, duke shkuar drejt bankave plotësisht virtuale. Por shumë shpejt, u pa se një hipotezë e tillë ishte shumë optimiste dhe se ishte nënvlerësuar roli i kanaleve tradicionale.

Internet banking ka sjellë pa dyshim një evolucion në sistemin bankar, pasi ka bërë të mundur "krijimin" e një filiali banke në shtëpinë e gjithsecilit dhe është i destinuar të



zhvillohet më tej. Megjithatë, historia e viteve të fundit na tregon se shërbimet bankare *online*, edhe në të ardhmen, do të kenë një funksion plotësues të atyre tradicionale. Aktualisht, modeli më i preferuar duket të jetë ai amerikan, i quajtur modeli "*clicks and mortar*", i cili nxit klientët të përdorin *internet banking* për transaksionet bazë, duke i lënë më të lirë punonjësit e bankave për shërbime si, planifikim apo drejtim financiar.

Me kalimin e kohës dhe me afirmimin e shërbimeve bankare *online*, ka gjasa që faqet e internetit të bankave të përdoren po aq sa sportelet dhe ATM-të. Të gjitha këto mënyra, do vazhdojnë të jenë pjesë e një modeli shumëkanalësh, si strategji optimale për t'i garantuar klientëve të tyre më tepër fleksibilitet, praktikitet dhe komoditet.

“Për shumë institucione, interneti është një dilemë. Përqafojeni atë dhe përsëri mund ta gjeni veten duke humbur terren në biznesin tuaj ose më e pakta, mund të shikoni fitimet tuaja të lëkunden. Por, injorimi i tij mund të jetë fatal.”

The Economist

Botime edukative të Bankës së Shqipërisë

Duke e konsideruar publikun si një hallkë të rëndësishme në procesin e transmetimit të vendimeve të saj, Banka e Shqipërisë përgatit një sërë botimesh edukative me tema të ndryshme, disa prej të cilave po i rendisim:

Banka e Shqipërisë - Banka jonë qendrore

Nëpërmjet një panorame të përgjithshme të historisë, strukturës dhe funksioneve të bankës qendrore, kjo broshurë i prezanton publikut Bankën e Shqipërisë. Si e realizon Banka e Shqipërisë objektivin e stabilitetit të çmimeve, si kontribuon ajo, me politikat e saj, në zhvillimin ekonomik dhe në mirëqenien e vendit dhe të tjera si këto pyetje, do t'u jepet përgjigje duke shfletuar këtë botim.

Paraja elektronike: e ardhmja e parasë?

Modernizimi i sistemit bankar ofron mundësi të shumta për mënjanimin e përdorimit të parasë cash. Një prej këtyre mundësive është përdorimi i parasë elektronike. Për të krijuar një ide më të qartë mbi këtë mundësi, Banka e Shqipërisë i ofron të gjithë përdoruesve të cash-it informacion bazë mbi këtë formë të re të parasë, avantazhet, disavantazhet e saj dhe mënyrat e ndryshme të përdorimit.

Borxhi dhe kredia = një çështje interesi

Borxhi ka ekzistuar që në kohët e mesjetës dhe deri në ditët tona. Ai ka marrë forma të ndryshme duke u zhvilluar në atë që ne e njohim sot me emrin kredi. Kjo broshurë informon publikun mbi format e ndryshme të kredive dhe si mund të aplikohet për një të tillë.

Në pritje të regjistrimit të kredive

Duke pritur që edhe Shqipëria të ketë Regjistrin e saj të parë të Kredive, Banka e Shqipërisë publikon këtë broshurë, e cila synon t'i shpjegojë publikut se çfarë është një regjistër kredie, si funksionon

ai, ç'lloj informacioni përmban dhe mbi të gjitha përse krijimi i tij është një domosdoshmëri për situatën aktuale shqiptare.

Departamentet në Bankën e Shqipërisë

“Departamentet në Bankën e Shqipërisë” i ribotuar, ju sjell informacion të rinovuar mbi disa ndryshime të bëra në Bankën e Shqipërisë, ndërkohë që risjell në vëmendjen e të gjithëve, një prezantim të bërë edhe më parë mbi detyrat dhe funksionet tashmë të konsoliduara, të pjesës tjetër të Bankës.

Përse duhet të keni një buxhet personal?

Buxheti mund të konsiderohet si hapi i parë për të arritur qëllimet tuaja financiare. Ai ju ndihmon të kontrolloni shpenzimet tuaja, duke krijuar mundësi që të shtoni kursimet. Në një farë mënyre buxheti është ndërgjegja juaj financiare. Ai tregon se sa fitoni dhe sa jeni duke shpenzuar.

Bankat qendrore të rajonit

Nëpërmjet një rrëfimi copëzash të historive të bankave të rajonit tonë, kjo broshurë synon të japë një panoramë të përgjithshme të asaj çka bën një bankë qendrore. Bankat janë si njerëzit: kanë jetët e historitë e tyre tipike, kuriozitetet, të thënat e të pathënat, rriten, ndryshojnë, transformohen, zhvillohen, kanë veçoritë e tyre që i dallojnë nga njëra-tjetra, por në thelb mbeten të njëjta.

Ç'është për ju stabiliteti i çmimeve?

Kjo broshurë përshkruan në mënyrë të thjeshtë dhe të detajuar qëndrueshmërinë e çmimeve dhe rëndësinë e saj për ekonominë e një vendi. Në tekst, do të gjeni shembuj të cilët janë marrë nga jeta e përditshme. Kjo broshurë shpjegon edhe konceptet e inflacionit e të deflacionit dhe ndërlikimet që ato sjellin në jetën e secilit.